

# NUMËRATORI EKONOMIK | 2013



## PERFORMANCA, BARRIERAT DHE BESUESHMËRIA E BIZNESEVE NË KOSOVË



INSTITUTI RIINVEST





**Përgatitur nga:**

**RIINVEST INSTITUTE:**

Agon Nixha, Gent Beqiri dhe Lumir Abdixhiku



**Botuar nga:**

**RIINVEST INSTITUTE**

Lidhja e Prizrenit nr. 42

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Tel: + 381 (0)38 244320; 223816

[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

E drejta autoriale © **2013** nga INSTITUTI RIINVEST. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem riprodhimi, apo të transmetohet, në asnjë formë apo nga asnjë mjet, qoftë elektronik, apo mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi.

# NUMËRATORI EKONOMIK | 2013

## PERFORMANCA, BARRIERAT DHE BESUESHMËRIA E BIZNESEVE NË KOSOVË



INSTITUTI RIINVEST

# PËRMBAJTJA

|                                                                    |           |
|--------------------------------------------------------------------|-----------|
| <b>Hyrja .....</b>                                                 | <b>5</b>  |
| <b>1. Metodologjia e përgjithshme .....</b>                        | <b>6</b>  |
| <b>2. Gjetje të përgjithshme për bizneset në Kosovë .....</b>      | <b>7</b>  |
| <b>3. Barrierat e bizneseve për vitin 2013 .....</b>               | <b>9</b>  |
| 3.1. Barrierat që lidhen me sundimin e ligjit .....                | 9         |
| 3.2. Barrierat fiskale dhe financiare .....                        | 11        |
| 3.3. Barrierat Infrastrukturore .....                              | 12        |
| 3.4. Barrierat e Brendshme .....                                   | 12        |
| 3.5. Barrierat burokratike dhe informative .....                   | 13        |
| 3.6. Barrierat tjera .....                                         | 13        |
| <b>4. Krahasoni i barrierave të 2013-ës me ato të 2011-ës.....</b> | <b>14</b> |
| <b>5. Besueshmëria e bizneseve .....</b>                           | <b>16</b> |
| 5.1. Rezultatet për besueshmërinë institucionale .....             | 16        |
| 5.2. Rezultatet për besueshmërinë ndër-personale .....             | 17        |
| 5.3. Krahasoni i llojeve të besueshmërisë .....                    | 18        |
| <b>6. Konkluzioni .....</b>                                        | <b>19</b> |
| <b>7. Referencat .....</b>                                         | <b>20</b> |

# HYRJA

Zhvillimi i sektorit privat paraqet një komponentë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Për ta pasur një pasqyrë të qartë të performancës dhe pengesave kryesore të bizneseve që operojnë në Kosovë, Instituti Riinvest ka zhvilluar një anketë me një mostër reprezentative të këtyre bizneseve. Më të dhënat e nxjerra nga kjo anketë, më konkretisht, ky raport tenton: (i) ta përshkruajë kuantitativisht performacën dhe strukturën e shitjeve të bizneset në Kosovë; (ii) t'i nxjerr në pah barrierat, t'i peshojë dhe krahasojë ato; dhe (iii) ta testojë besueshmërinë e këtyre bizneseve ndaj institucioneve dhe palëve tjera bashkëpunuese.

Sa i përket pikës së parë, nga anketa del se shumica e bizneseve kanë pësuar rënie të shitjeve. Gjithashtu, e njëjta konstaton se një përqindje e madhe e shitjeve të këtyre bizneseve bëhet në vend (kryesisht tek konsumatorët familjarë) dhe shumë pak eksportohet. Në relacion me pikën e dytë, rezultatet e anketës tregojnë se barrierat që lidhen me sundimin e ligjit (psh. konkurrenca jo fer, korrupsioni, funksionimi i gjykatave etj.) konsidero-

hen si barrierat me serioze për bizneset në Kosovë. Ndikimi i tyre madje është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2011. Në fund, anketa konstaton se bizneset më shumë i besojnë stafit, furnitorëve dhe blerësve se sa institucioneve, gjegjësisht Qeverisë dhe komunës përkatëse.

Pjesa e mbetur e studimit është organizuar siç vijon. *Seksioni 1* prezanton metodologjinë e përgjithshme të raportit, duke i vënë theks mënyrës së zhvillimit të anketës. *Seksioni 2* ofron disa gjetje kryesore të anketës mbi bizneset që operojnë në Kosovë. *Seksioni 3* rendit dhe vlerëson barrierat në bizneset e Kosovës në vitin 2013. *Seksioni 4* krahason barrierat e këtij viti me ato të vitit 2011 dhe rrjedhimisht nxjerr në pah ndryshimet. *Seksioni 5* tregon për besueshmërinë e bizneseve duke e ndarë atë në besueshmëri institucionale (besimi në Qeveri dhe komunë përkatëse) dhe ndër-personale (besimi në staf, furnitorë dhe blerës); në fund të këtij seksioni behët krahasimi i dy llojeve të besueshmërisë. *Seksioni 6* përmbledh raportin.

# 1. METODOLOGJIA E PËRGJITHSHME

Për ta punuar këtë studim janë përdorur të dhëna primare dhe sekondare. Përmes këtyre mënyrave të hulumtimit, të cilat më detajisht do të përshkruhen më poshtë, tentohet të pasqyrohet gjendja reale tek biznese që operojnë në Kosovë.

Të dhënat primare janë mbledhur përmes një ankete e cila i ka përfshirë 600 biznese të Kosovës. Përzgjedhja e bizneseve është bërë nga baza e të dhënave e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK-së). Mostra e hulumtimit është stratifikuar në bazë të qytetit dhe sektorit në të cilin operon biznesi, gjë që ka bërë që rezultatet e anketës të jenë mjaft signifikante. Para se të zhvillohej anketa, fillimisht është testuar struktura dhe përmbajtja e pyetësorit me 50 biznese në mënyrë që të sigurohej se a janë pyetjet e kuptueshme për bizneset dhe a ka ndonjë nevojë për modifikim. Pyetësi është

zhvilluar me pronarë ose menaxherë të bizneseve, meqë këta konsiderohen si më të informuarit për sa i përket rrjedhës së biznesit.

Hulumtimi sekondar është bërë në mënyrë që ekipi i Riinvest-it të familjarizohet me shumë me temën që do të trajtohet në këtë studim. Më konkretisht, ky hulumtim është zhvilluar që: të krijohet një bazë për përpilimin e pyetësorëve; të sigurohen të dhëna të tjera për t'i mbështetur gjetjet e anketës me biznese; dhe aty ku është nevoja, të krahasohen gjetjet e kësaj ankete me ato të vendeve ku është trajtuar tematika e njëjtë. Që të arrihet këto tri pika, janë konsultuar punime online, artikuj akademik, raporte ndërkombëtare si për shembull, Banka Botërore (BB), Departamenti Amerikan i Shtetit dhe institucionet tjera të statistikave.

## 2. GJETJE TË PËRGJITHSHME PËR BIZNESET NË KOSOVË

Mesatarisht 89% e shitjeve të bizneseve të intervistuar realizohen në vend, ndërsa 11% eksportohen në vendet tjera (shih Figurën 1). Në këtë grup, ato që dallojnë lehtë nga mesatarja janë bizneset e vogla (10 deri në 50 punëtorë) me 5 pikë përqindje (pp) më shumë shitje jashtë vendit apo gjithsej 16%. Për më shumë, bizneset e rajonit të Prishtinës kanë eksportuar më së shumti në krahasim me rajonet tjera. Nga shitjet e përgjithshme të bizneseve të këtij rajoni, 17% e përbën eksporti. Në këtë aspekt, ky rajon pasohet nga rajoni i Prizrenit, bizneset e të cilit eksportojnë 13% të prodhimeve dhe shërbimeve të tyre.

Në krahasim me vitin paraprak, mesatarisht 54% e bizneseve kanë pësuar rënie të shitjeve, 21% kanë shënuar rritje dhe 25% nuk e kanë shënuar ndonjë ndryshim.

Mesatarisht 54% e bizneseve kanë pësuar rënie të shitjeve, 21% kanë shënuar rritje dhe 25% nuk e kanë shënuar ndonjë ndryshim (Shih Figurën 2). Për të qenë më specifik, përqindja e rritjes tek bizneset që kanë shënuar rritje ka qenë 22%, ndërsa përqindja e rënies tek ato që kanë pësuar rënie ka qenë afërsisht 34%. Thënë shkurt, shumica e bizneseve që operojnë në Kosovë kanë pësuar rënie shqetësuese të shitjeve.

Nëse analizohen rezultatet e rritjes/rënies së shitjeve në bazë të madhësisë së biznesit, del se tek bizneset e mesme/mëdha (50 e më shumë punëtorë) proporcioni është i kundërt, pra ka më shumë biznese që shënojnë rritje. Më konkretisht, rritja tek këto biznese ka rezultuar të jetë 65%, ndërsa rënia 25%. Pjesa e mbetur (10%) nuk kanë

### SHITJET BRENDË DHE JASHTË VENDIT




FIGURA 1. PËRQINDJA E SHITJEVE BRENDË DHE JASHTË VENDIT

### TRENDI I SHITJEVE




FIGURA 2. TRENDI I SHITJEVE


shënuar ndonjë ndryshim të theksuar. Megjithatë, vlen të theksohet se këto biznese përbëjnë një numër shumë më të vogël të bizneseve që operojnë në Kosovë; rrjedhimisht, ndikimi i tyre në mesatare është shumë i ulët.

Në anën tjetër, më së shumti rënie kanë pësuar bizneset të cilat janë hapur para vitit 1999. Për të qenë më konkret, 70% e bizneseve që janë hapur gjatë kësaj periudhe kanë pësuar rënie, vetëm 12% rritje dhe pjesa e mbetur (18%) nuk e kanë shënuar ndonjë ndryshim që vlen të theksohet. Për më tepër, nga të gjitha bizneset e intervistuar, dallohen ato të rajonit të Pejës, ku një përqindje e madhe e tyre kanë pësuar rënie. Rënie në këtë rajon kanë pësuar 69% e bizneseve, rritje vetëm 10%, ndërsa pjesa e mbetur nuk kanë treguar ndonjë ndryshim.

Afërsisht 72% e të hyrave tek bizneset e anketuara janë realizuar nga konsumatorët familjarë, 25% nga bizneset dhe 3% nga Qeveria (Shih Figurën 3). Nëse shqyrtohen rezultatet në bazë të madhësisë së biznesit, del se tek mikro bizneset (0 deri në 9 punëtorë), 75% e të hyrave janë realizuar nga konsumatorët familjarë, 23% nga bizneset dhe vetëm 2% nga Qeveria. Tek bizneset e vogla dhe të mesme poashtu dominojnë të hyrat nga

Afërsisht 72% e të hyrave tek bizneset e anketuara janë realizuar nga konsumatorët familjarë, 25% nga bizneset dhe 3% nga Qeveria.

## TË HYRAT E BIZNESEVE



**FIGURA 3.** KLIENTËT E BIZNESEVE TË NDARË SIPAS PËRQINDJES

konsumatorët familjar me 53% respektivisht 52%, të cilat pasohen me të hyrat nga bizneset me 39% respektivisht 40% dhe Qeveria me 8% për secilën. Siç shihet për këto dy kategori të bizneseve,

Qeveria dhe bizneset kanë peshë më të madhe në aspektin e shitjeve në krahasim me kategorinë e parë. Në një analizë më të detajuar, del se bizneset që kanë më së shumti të hyra nga Qeveria janë bizneset e mesme/mëdha që operojnë në rajonin e

Prishtinës. Më specifikisht, të hyrat nga Qeveria tek këto biznese përbëjnë afër 13% të shitjeve.

### 3. BARRIERAT E BIZNESEVE PËR VITIN 2013

Vlerësimi i barrierave në të bërit biznes nga vet bizneset paraqet një pasqyrë të rëndësishme e cila u shërben hisedarëve të ndryshëm në përpjekje për përmirësim të mjedisit biznesor. Për t'i peshuar dhe krahasuar barrierat e të bërit biznes në Kosovë, së pari, ekipi i Riinvest-it i ka listuar 24 barrierat potenciale, kryesisht duke iu referuar rangimit të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe BB-së. Më pas, në anketën e zhvilluar me përfaqësues të bizneseve, atyre iu

është kërkuar t'i vlerësojnë këto barrierat nga 1 – nuk është barrierë deri tek 5 – barrierë shumë e madhe. Në fund është kalkuluar intensiteti si njësi matëse e tyre. Me këtë lloj njësie barrierat mund

të variojnë nga 20 deri në 100 pikë<sup>1</sup>. Në vazhdim do të prezantohen rezultatet për secilën barrierë dhe ku është e mundur me vlerësime të raporteve vendore dhe ndërkombëtare. Rezultatet janë përmbledhur në Tabelën 1.

#### 3.1 BARRIERAT QË LIDHEN ME SUNDIMIN E LIGJIT

Barriera më serioze në këtë kategori është konkurrenca jo fer (kryesisht nga evazioni fiskal), e cila është vlerësuar me intensitet 84 pikë. Që kjo barrierë

është shumë serioze, reflektohet edhe në raportin për informalitet të realizuar poashtu nga Instituti Riinvest (2013). Sipas këtij raporti, evazioni fiskal konsiderohet të jetë afër 40%. I njëjti raport konstaton që afërsisht 36% e punëtorëve në bizneset në Kosovë nuk deklarohen; rasti më ekstrem është ai i sektorit të bujqësisë ku përqindja e punëtorëve që nuk deklarohen arrin deri në 70%.

Konkurrenca jo fer në listën e barrierave pas-

Barriera më serioze në të bërit biznes është vlerësuar konkurrenca jo fer (kryesisht nga evazioni fiskal).

ohet nga korrupsioni me intensitet 78. Dominimi i kësaj barriere nuk është i papritur marrë parasysh që edhe indikatorët ndërkombëtarë të korrupsionit, pavarësisht mënyrës së matjes, sugjerojnë që Kosova vazhdon të

jetë njëri ndër vendet më të korruptuara në rajon. International Transparency (2012), për shembull, në një vlerësim nga 1 deri në 100, ku sa më e madhe të jetë nota aq më pak e korruptuar është shoqëria, sugjeron që korrupsioni është perceptuar me notën 34, duke bërë që Kosova të renditet në vendin e 105-të, më poshtë se Maqedonia, Mali i Zi dhe vendet tjera të rajonit, përveç Shqipërisë. Në vazhdim, në vendin e tretë, është ranguar barrierat e krimit të rrugëve dhe hajnisë me intensitet 74 pikë. Edhe organizatat ndërkombëtare e konsiderojnë këtë dukuri si problematike. Departamenti Amerikan i Shtetit, për shembull, konstaton që kosovarët, të shtyrë nga papunësia dhe faktorët tjerë socio-ekonomik, involvohen në krim të rrugëve, gjegjësisht në vjedhje, dhe kështu bëjnë që Kosova të renditet jo mirë krahas vendeve tjera. Ky departament dokumenton që edhe bizneset, ndër të tjera, janë subjekt i këtyre vjedhjeve. Më tutje, në vendin e katërt, sërish vijnë

1 Për çdo barrierë, renditja e dhënë nga çdo ndërmarrje (prej 1-5) shumëzohet me një peshë të barabartë me renditjen (gjithashtu 1-5), p.sh., barrierat më serioze marrin peshë më të madhe. Mesatarja e ponderuar pastaj pjesëtohet me 5 (renditjen maksimale) dhe shumëzohet me 100 në mënyrë që rezultati të kthehet në përqindje e cila tregon se sa afër renditjes maksimale gjendet renditja mesatare. Thënë ndryshe, rezultati është kalkuluar si në vijim:  $s = (w_i x_i / n) * 100 / 5$ , ku  $w_i = x_i$ ;  $s$  është rezultati i intensitetit për çdo barrierë,  $w$  është peshat,  $x$  është renditja e dhënë nga çdo respondent dhe  $i=1,2,\dots,n$  përfaqëson secilin respondent

**TABELA 1. BARRIERAT E BIZNESEVE PËR VITIN 2013 SIPAS PIKËVE TË INTENSITETIT**

|    | BARRIERAT BIZNESORE                                     | (INTENSITETI) |
|----|---------------------------------------------------------|---------------|
| 1  | Konkurrenca jo fer (evazioni fiskal dhe informaliteti)  | 84            |
| 2  | Korrupsioni                                             | 78            |
| 3  | Krimi i rrugës, hajnia dhe mungesa e rregullit          | 74            |
| 4  | Praktikat jo konkurruese të konkurrentëve tjerë         | 72            |
| 5  | Krimi i organizuar dhe mafia                            | 69            |
| 6  | Mbledhja e borxhit                                      | 69            |
| 7  | Funksionimi i sistemit gjyqësor                         | 68            |
| 8  | Mungesa e stabilitetit politik                          | 68            |
| 9  | Mungesa e sigurisë për rregullore politike              | 66            |
| 10 | Kostoja e financimit                                    | 65            |
| 11 | Normat tatimore                                         | 60            |
| 12 | Qasja në financa                                        | 59            |
| 13 | Administrata tatimore                                   | 58            |
| 14 | Mos-respektimi i kontratave nga furnitorët dhe klientët | 55            |
| 15 | Doganat dhe rregullativa tregtare                       | 52            |
| 16 | Furnizimi me energji elektrike                          | 51            |
| 17 | Standardet e prodhimit                                  | 50            |
| 18 | Licencat dhe lejet për biznes                           | 43            |
| 19 | Qasja në informacione të shërbimeve biznesore           | 43            |
| 20 | Qasja në tokë                                           | 41            |
| 21 | Transporti                                              | 39            |
| 22 | Shkathësitë dhe arsimimi punëorëve aktual               | 39            |
| 23 | Rregullativa e punës                                    | 38            |
| 24 | Telekomunikacioni                                       | 36            |

çështjet që lidhen me konkurrencën, përkatësisht barriera e praktikave jo-konkurruese të konkurrentëve. Kjo tani vlerësohet me intensitet 72 pikë. Për ndryshim nga konkurrenca jo fer që është rezultat i relacioneve të bizneseve me Qeverinë, praktikat jo-konkurruese janë praktika që aplikohen nga vet bizneset pa ndihmën e Qeverisë.

Krimi i organizuar, që ndërlidhjet me barrierat

që u përmendën, është konsideruar poashtu si barrierë serioze duke u renditur si i pesti në listën e gjithmbarshme të barrierave me intensitet 69 pikë. Që krimi i organizuar vazhdimisht ka paraqitur një pengesë kryesore për shoqërinë kosovare, e veçanërisht për bizneset, konstatohet edhe nga Zyra e Bashkimit Evropian për Krim dhe Inteligjencë. Kjo zyre në punimin 'Krimi i Organizuar në Kosovë'

(2010) konkludon se qysh nga pas-lufta kur komuniteti ndërkombëtar ka zbarkuar në Kosovë, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të ndjeshëm sa i përket krimit të organizuar; krimi i organizuar sipas këtij raporti vazhdon të jetë ende prezent në Kosovë. Ky konstatim, pra, mbështet faktin që kjo barrierë është mjaftë serioze dhe pozicionimi i saj në anketën e Riinvest-it nuk është i rastësishëm.

Në këtë anketë, nisur nga rrethanat e fundit dhe nga para-perceptioni që është marrë rëndom nga takimet me bizneset kosovare, janë shtuar edhe dy barrierë që më parë nuk kanë zënë vend në analizat e këtij lloji; ato janë mbledhja e borxhit dhe mungesa e sigurisë në politikat rregulluese. Ndonëse mbledhja e borxhit është futur për herë të parë në listën e gjithmbarshme të barrierave, megjithatë është renditur si e gjashta me intensitet 69 pikë. Kur kihet parasysh mesatarja tejet e lartë e normave të interesit (kostoja e lartë e parasë), eksporti që mbulon vetëm 12% (ASK, 2013) të importit (rrjedha e jashtme e parasë) dhe përgjithësisht situata e rënduar ekonomike, nuk është e çuditshme që borxhi të jetë tipar i të bërit biznes në vend. Barrierë tjetër e shtuar, pra mungesa e sigurisë në politikat rregulluese, do të shpjegohet në seksionin e barrierave tjera meqë nuk lidhet me këtë kategori.

Funksionimi i sistemit gjyqësor dhe mungesa e stabilitetit politik renditen si e shtata respektivisht e teta me intensitet 68 pikë në të dyja rastet. Ekzistojnë gjithashtu edhe indikatorë të tjerë që i nënvizojnë këto barrierë si problematike. Indikatorët Qeverisë nga BB-ja, përkatësisht indikator i rendit dhe ligjit për Kosovën në vitin 2012, në një rangim prej -2.5 deri 2.5, ku sa më i madh të jetë indikator i aq më mirë qëndron shteti sa i përket rendit ligjor, rezultojnë të jetë -0.56, me dobëti se vendet fqinje si Mali i Zi (-0.01), Maqedonia (-0.24) dhe Serbia (-0.39).

Pra konkurrenca jo fer, korrupsioni, krimi i rrugëve dhe hajnia, praktikat jo-konkurrense të

konkurrentëve, krimi i organizuar, mbledhja e borxhit, mungesa e stabilitetit politik dhe mos-funksionimi i gjyqësorit, janë perceptuar si barrierat më serioze. Të gjitha këto e kanë një emërues të përbashkët--mungesën e sundimit të ligjit.

### 3.2 BARRIERAT FISKALE DHE FINANCIARE

Të katër barrierat nga vendi i 10-të deri në të 13-in, kanë të bëjnë me dy fusha, potencialisht më të mençura. Zgjidhja e tyre, pra, kërkon më shumë mendje se vullnet. Në vendin e 10-të bizneset kosovare e rendisin barrierën e koston së financimit, pra normat e interesit nga institucionet financiare, me intensitet 65 pikë; në vendin e 11-të barrierën e normave tatimore me intensitet 60 pikë, me siguri duke aluduar në pagesën e TVSh-së; në vendin e 12-të kthehen sërish tek çështjet e financimit për ta ranguar si pengesë serioze barrierën e qasjes në financa, pra mundësinë e marrjes së kredisë, me intensitet 59 pikë; për t'u kthyer sërish në çështjet tatimore, përkatësisht në barrierën e administratës tatimore duke e renditur si të 13-ën me intensitet 58 pikë.

Pra këto katër barrierë i përkasin dy fushave kryesore. E para ka të bëjë me financimin, të përkthyer në kosto dhe në qasje të kredive; ndërsa e dyta ka të bëjë me politikat fiskale të përkthyer në norma dhe administratë tatimore. Pozicionimi në pjesën e parë të tabelës i barrierave të financimit nuk është i rastësishëm marrë parasysh normat e interesit, të cilat janë më të lartat në rajon – 13% mesatarja – dhe problemet që lidhen me pronën dhe pamundësinë e mbështetjes së kredisë. Në lidhje me barrierat fiskale, normat tatimore në fitim dhe paga mbesin në rang normal, mirëpo ngarkesat e tjera të ndërlidhura me TVSH-në vazhdojnë të jenë barrierë serioze

---

Barrierat me serioze tek bizneset ndërlidhen me mungesën e sundimit të ligjit.

---

në qarkullimin e parasë nga bizneset. Këtë qarkullim e rëndon edhe më tepër ATK-ja me problemet e saja të konsiderueshme (siç edhe shihet nga vetë rangimi). UNDP-ja në Raportin e Zhvillimit Human nënvizon se ATK-ja konsiston me vetëm 350 inspektorë, të cilët janë të pa mjaftueshëm për t'i mbuluar të gjitha bizneset që operojnë në Kosovë. Në nën-seksionet në vijim janë renditur barrierat të cilat përfaqësuesit e bizneseve i kanë vlerësuar si me më pak ndikim në të bërit biznes në Kosovë.

Telekomunikacioni dhe transporti janë konsideruar si barrierat me më së paku ndikim në të bërit biznes.

imin apo restaurimin e rrugëve. Që është investuar shumë në rrugë, e vërteton edhe grafi i dizajnuar nga Instituti GAP mbi buxhetin e Kosovës, i cilin tregon se 22.4% e buxhetit në vitin 2012 është shpenzuar në rrugë; më shumë se për secilin sektor tjetër. Përgjithësisht, të tri këto barrierat, me të drejtë, konsiderohen si me të padëmshme marrë parasysh koncentrimin e Qeverisë në vitet e fundit kryesisht në infrastrukturë dhe investime kapitale.

### 3.3 BARRIERAT INFRASTRUKTURE

Nga të tri barrierat infrastrukturore të listuara në anketë, telekomunikacioni konsiderohet si barriera me më së paku ndikim në të bërit biznes, madje edhe në listën e gjithmbarshme është renditur si e fundit. Intensiteti me të cilën është peshuar kjo barriërë është vetëm 36 pikë. Dy barrierat tjera infrastrukturore, energjia elektrike dhe transporti, gjenden më keq në krahasim me telekomunikacion, por prapë se prapë qëndrojnë më mirë në krahasim me barrierat që lidhen me sundimin e ligjit dhe me barrierat fiskale dhe financiare. Barriera e furnizimit me energji elektrike është renditur e 16-ta (në vitin 2007 i printe listës së barrierave) me një intensitet 51 pikë, ndërsa ajo e transportit është renditur si e 21-ta me 39 pikë. Barriera e transportit, ashtu edhe siç ka dalë, është pritur të jetë nga fundi i kësaj tablele duke marrë parasysh investimet në ndërtimin, zgjer-

Barrierat të cilësuar si të brendshme (shkathtësitë e punëtorëve, rregullorja për punëtorë dhe standardet e prodhimit) vlerësohen si më të padëmshme në krahasim me barrierat që lidhen me sundimin e ligjit dhe me çështjet fiskale e financiare.

### 3.4 BARRIERAT E BRENDSHME

Barrierat të cilësuar si të brendshme, gjithashtu janë vlerësuar si më të padëmshme në krahasim me barrierat që lidhen me sundimin e ligjit dhe me çështjet fiskale e financiare. Në grupin e barrierave të brendshme, ajo e standardeve të prodhimit konsiderohet si me e rënda duke u renditur si e 17-ta me intensitet 50 pikë. Si më pak serioze janë kategorizuar barrierat e shkathtësive të punëtorëve dhe e rregullave për punëtorë duke u renditur si e 22-ta respektivisht 23-ta me intensitet 39 respektivisht 38 pikë. Sa i përket barrierës që lidhet me standardet e prodhimit, një arsye për këtë qëndrim, është fakti se shumica e bizneseve kosovare, në mungesë të kapaciteteve për të eksportuar, fokusohen vetëm në tregun vendas, i cili është më tolerant ndaj mos-respektimit të standardeve globale të prodhimit. Që bizneset kosovare shumë pak eksportojnë (sidomos në krahasim me sa importojnë), vërtetohet edhe në të dhënat e BB-së. Sipas BB-së, përqindja e eksportit në GDP-në e

Kosovës është 20, shumë më pak se vendet e rajonit si psh. Maqedonia 58%, Mali i Zi 41% etj. Në anën tjetër, arsyeja për pozicionimin e lartë-përmendur të barrierës së shkathtësive të punëtorëve lidhet me natyrën e punëve tek bizneset e intervistuar, e cila nuk kërkon ndonjë përgatitje të avancuar e cila mungon në tregun e punës në Kosovë.

Kategorizimi i lehtë i këtyre barrierave, përveç tjerash, ka të bëjë edhe me faktin se bizneset kosovare në vazhdimësi i kanë konsideruar këto barriera (me apo pa të drejtë) si të brendshme, pra që varen vetëm nga ta, dhe rrjedhimisht më pak të dëmshme dhe më pak problematike për punën e tyre – prandaj dhe rëndom do të mbesin me këtë qëndrim. Me fjalë tjera, meqë përgjegjësia për t'i lehtësuar këto barriera bie mbi ta, bizneset kosovare mendohet të kenë qenë subjektiv duke e mbivlerësuar potencialin e brendshëm.

### 3.5 BARRIERAT BUROKRATIKE DHE INFORMATIVE

Nga barrierat burokratike dhe informative, ajo për doganat dhe rregullat e tregtisë është vlerësuar si më seriozja në krahasim me barrierat tjera të kësaj kategorie, duke u pozicionuar si e 15-ta me intensitet 52 pikë. Edhe vlerësimet e BB-së e konsiderojnë këtë si barrierë. Raporti i kësaj organizate, 'Doing Business', e rendit Kosovën në vendin e 124-ët, më keq se mesatarja e Evropës Lindore dhe e Azisë Qendrore (107) sa i përket lehtësisë së lëvizjes së mallrave përtej kufirit. Më specifikisht, sipas këtij raporti, për të eksportuar një kontinier të zakonshëm me mallra nevojiten 8 dokumente, që marrin 15 ditë për t'u nxjerrë me një kosto prej 1775 dollarësh. Barriera e licencave dhe lejeve për biznes renditet më poshtë, pra më lehtë, në vendin e 18 me intensitet 43 pikë. Në këtë aspekt, nëse merret në total indikatori i hapjes së bizneseve në

raportin 'Doing Business' të BB-së, që tërthorazi i përfshin edhe licencat dhe lejet për biznes, shihet se Kosova ka shënuar përmirësime duke u zhvendosur nga vendi 170-të që ishte në vitin 2011 në vendin e 126-të në vitin 2012. Pas barrierave që lidhen me licencat dhe lejet për biznes, pason barriera e qasjes në shërbime dhe informata të bizneseve në vendin 19-të me intensitet 43. Kryesisht bizneset nuk kanë ndonjë rregullore për konfidencialitet, gjë që bën që informatat të qarkullojnë përtej firmës.

### 3.6 BARRIERAT TJERA

Tek barrierat e tjera të mbetura hyjnë ajo e mungesës së sigurisë në politikat rregulluese e renditur e 9-ta me intensitet 66 pikë; mos-respektimi i kontratave nga furnitorët dhe blerësit e 14-ta me intensitet 55 pikë; dhe qasja në tokë e 20-ta me intensitet 41 pikë. Vlerësimi jo i mirë i mungesës së sigurisë në politika rregulluese, është bërë për faktin se kjo ndërlidhet me institucionet formale, të cilave bizneset shumë pak u besojnë. Ndërkaq, sa i përket mos-respektimit të kontratave nga furnitorët dhe blerësit, tregu i vogël dhe rrjedhimisht kontakti i vazhdueshëm me këta të fundit, i bën përfaqësuesit tu besojnë më shumë këtyre dhe ta shohin respektimin e kontratave si më pak problem. Tema e besueshmërisë së bizneseve do të trajtohet më gjerësisht në seksionin për besueshmërinë. Qasja në tokë, ndërlidhet me çmimin e parcelave dhe siç shihet, bizneset nuk e vlerësojnë këtë si ndonjë barrierë me shumë ndikim.

## 4. KRAHASIMI I BARRIERAVE TË 2013-ËS ME ATO TË 2011-ËS

Instituti Riinvest tash e sa vite zhvillon anketa me biznese ku theks i veçantë u është vënë barrierave. Metodologjia që është përdorur në këto anketa është e njëjtë me të lartë-përshkruarën, vetëm lloji dhe numri barrierave të listuara është ndryshuar varësisht nga rrethanat e para-perceptuara të vitit përkatës. Replikimi i së njëjtës metodologji, krijon hapësirë për krahasimin e këtyre barrierave ndër vite. Për të shfrytëzuar këtë përparësi, në këtë punim, si bazë krahasuese për anketën e fundit do të merret viti 2011. Vlen të ceket se krahasimi nuk mund të bëhet

për vetëm dy barriera që iu janë shtuar anketës së fundit dhe që nuk janë në të kaluarën, fjala është për mbledhjen e borxhit dhe për mungesën e sigurisë në politikat rregulluese. Barrierat tjera të listuara janë të njëjtat, prandaj nuk është problem krahasimi.

Rezultatet për të dyja vitet paraqiten në Tabelën 2. Kur krahasohen rezultatet e këtyre dy viteve, del se nga 22 barrierat e krahasueshme në të bërit biznes, 18 kanë pësuar rënie, 3 kanë shënuar përmirësim dhe 1 ka mbetur e pa ndryshuar. Ndonëse shumica e barrierave kanë shënuar rëndesë, megjithatë, përt' i dhënë një ngjyrë më pozitive studimit, elaborimi se si secila barrierë ka ndryshuar gjatë kësaj periudhë do të bëhet nga ato që kanë shënuar përmirësim deri tek ato që kanë pësuar rënie.

Në mesin e atyre që kanë shënuar përmirësim janë barriera e energjisë elektrike (-13 pikë), e transportit (-1 pikë) dhe e mos-respektimit të kontratave nga furnitorët dhe blerësit (-5 pikë); kryesisht pra barriera infrastrukturore. Ky përmirësim me së miri e rumbul-

lakon angazhimin qeveritar në Kosovë viteve fundit të përqendruar tej mase në infrastrukturë, pra kryesisht në rrugë, energji e telekomunikacion. Ajo që ka mbetur në nivel të pandryshuar nga viti 2011 është barriera e rregullores së punës.

Në grupin e barrierave që kanë pësuar rënie krahasuar më 2011-ën, por të lehtë (kryesisht 3 pikë), hyjnë: praktikat jo konkurruese të konkurentëve, qasja në financa; barrierat e brendshme, shkathësitë e punëtorëve, standardet e prodhimit, qasja në informacione për shërbimet e biznesit, licencat

dhe lejet për biznes, rregulloret e tregtisë dhe qasja në tokë. Pra, ndonëse edhe këto kategori janë në regres, konsiderohet se regresi i tyre është më i lehtë, potencialisht rezultat i ndonjë gabimi statistikor dhe pa ndonjë tendencë të madhe shqetësuese. Gjithsesi, pozicionimi i këtyre fushave në intensitete pothuajse të njëjta ndaj

Nga 22 barrierat e krahasueshme në të bërit biznes, 18 kanë pësuar rënie, 3 kanë shënuar përmirësim dhe 1 ka mbetur e pa ndryshuar, në krahasim me 2011-ën.

njëra-tjetër, dëshmon edhe kredibilitetin e anketave të bëra në dy periudha plotësisht të ndryshme me dy grupe plotësisht të ndryshme biznesesh.

Të gjitha barrierat tjera që kryesisht pozicionohen në pjesën e parë të tabelës kanë shënuar rritje. E njëjta barrierë që i printe listës në anketën e 2011-ës, ajo e konkurrencës jo fer, vazhdon të jetë e para edhe në anketën e fundit, madje me intensitet më të lartë (+ 8 pikë). Korrupsioni i perceptuar si barrierë, bën regresin më të madh në krahasim me secilën barrierë tjetër, për plot 4 vende, nga vendi i 6-të sa ishte në vitin 2011 në të 2-in në anketën e këtij viti. Përveç këtij kërcimi në renditje, ende më shqetësues është fakti se intensiteti ka shënuar ngritje enorme për plot 15

**TABELA 2. KRAHASIMI I BARRIERAVE TË VITIT 2013 ME ATO TË VITIT 2011  
SIPAS INTESITETIT**

| BARRIERAT BIZNESORE |                                                         | 2013 | 2011 | NDRYSHIMI |
|---------------------|---------------------------------------------------------|------|------|-----------|
| 1                   | Konkurrenca jo fer (evazioni fiskal dhe informaliteti)  | 84   | 76   | +8        |
| 2                   | Korrupsioni                                             | 78   | 63   | +15       |
| 3                   | Krimi i rrugës, hajnia dhe mungesa e rregullit          | 74   | 65   | +9        |
| 4                   | Praktikat jo konkurruese të konkurrentëve tjerë         | 72   | 69   | +3        |
| 5                   | Krimi i organizuar dhe mafia                            | 69   | 62   | +7        |
| 6                   | Funksionimi i sistemit gjyqësor                         | 68   | 54   | +14       |
| 7                   | Mungesa e stabilitetit politik                          | 68   | 59   | +9        |
| 8                   | Kostoja e financimit                                    | 65   | 58   | +7        |
| 9                   | Normat tatimore                                         | 60   | 50   | +10       |
| 10                  | Qasja në financa                                        | 59   | 57   | +2        |
| 11                  | Administrata tatimore                                   | 58   | 50   | +8        |
| 12                  | Mos-respektimi i kontratave nga furnitorët dhe blerësit | 55   | 60   | -5        |
| 13                  | Doganat dhe rregullativa tregtare                       | 52   | 48   | +4        |
| 14                  | Furnizimi me energji elektrike                          | 51   | 64   | -13       |
| 15                  | Standardet e prodhimit                                  | 50   | 47   | +3        |
| 16                  | Licencat dhe lejet për biznes                           | 43   | 40   | +3        |
| 17                  | Qasja në informacione të shërbimeve biznesore           | 43   | 38   | +5        |
| 18                  | Qasja në tokë                                           | 41   | 36   | +5        |
| 19                  | Transporti                                              | 39   | 40   | -1        |
| 20                  | Shkathtësitë dhe arsimimi i punëtorëve                  | 39   | 38   | +1        |
| 21                  | Rregullativa e punës                                    | 38   | 38   | 0         |
| 22                  | Telekomunikacioni                                       | 36   | 35   | +1        |

pikë; më së shumti nga të gjitha barrierat e listuara. Rekord në ndryshim të intensitetit ka shënuar edhe barrierat e funksionimit të gjyqësorit e cila, sipas të anketuarve, është degraduar duke u renditur nga vendi i 11-të në të 6-in.

Në vendet e ndërmjetme pas barrierës së konkurrencës jo fer dhe korrupsionit janë pozicionuar barrierat kriminale dhe e hajnisë, krimi i organizuar dhe mafia dhe praktikat jo konkurruese të konkurrentëve. Ndryshimi i intensitetit për dy të parat është 9 respektivisht 7 pikë, ndërsa për të tretën, përkundër faktit që

ndryshimin që e ka shënuar është i vogël, vazhdon të jetë në këtë mes meqë intensiteti edhe në anketën e kaluar ka qenë shumë i madh. Pas këtyre, barrierat tjetër që lidhet me sundimin e ligjit, poashtu, është mungesa e stabilitetit politik, e cila ka shënuar rritje të intensitetit për 9 pikë.

Ndërkaq ngritja e intensitetit për barrierat fiskale dhe financiare nuk ka qenë edhe shumë e madhe me përjashtim të barrierës së normave tatimore që ka shënuar rritje dyshifrore prej 10 pikësh.

## 5. BESUESHMËRIA E BIZNESEVE

Besueshmëria (anglisht: 'trust') definohet si besim i fuqishëm në integritet, mundësi dhe karakter të një personi apo një grupi njerëzish (Fjalori i Oxfod-it, 2013). Sikurse për disiplinat tjera, besueshmëria përbën një komponentë shumë të rëndësishme për bizneset, kontributi i së cilës është kryesisht përmes zvogëlimit të kostos së transaksioneve (Williamson, 1985). Ky dimension social tek bizneset kategorizohet në dy kategori kryesore: në besueshmëri ndër-personale dhe institucionale. E para rrjedh nga eksperiencia personale që kanë bizneset me furnitorë, blerës apo biznese tjera (Offe, 1999); ndërsa e dyta rrjedh nga observimi i cilësisë dhe punës së ndonjë institucioni në një kontekst institucional të caktuar (Rothstein dhe Stolle, 2001). Kjo e fundit,

në kontekstin e këtij studimi, paraqet besimin që bizneset kanë në qeverisje qendrore, lokale apo në gjykata. Për më shumë, efekti i kësaj besueshmërie është në strukturimin insentivave ku si rezultat bizneset hyjnë në marrëveshje të ndryshme bashkëpunuese dhe kështu përmi-rësojnë mundësitë e tyre dhe disponimin e resurseve.

Për ta matur besueshmërinë ndër-personale dhe institucionale, ekipi i Riinvest-it në anketën e zhvilluar me biznese ia ka dedikuar një seksion pyetjeve që ndërlidhen me këtë temë. Gjetjet për besueshmërinë janë të prezantuara në pasazhet në vijim të këtij seksioni.

### 5.1 REZULTATET PËR BESUESHMËRINË INSTITUCIONALE

#### BESIMI NË QEVERI




FIGURA 4. BESIMI NË QEVERI

Besueshmëria e bizneseve në Qeveri, komunë përkatëse dhe gjykata është e përmbledhur në Figurat 4,5 dhe 6. Në pyetjen se sa i besojnë bizneset kosovare Qeverisë, del se afërsisht 58% e tyre nuk besojnë fare ose jo shumë në këtë të fundit, rreth 15% janë neutral dhe 27% besojnë deri diku ose shumë. Vlen të ceket se përqindjen e fundit në masë të madhe e dominon opsioni "deri diku". Besueshmëria në Qeveri është shumë e ulët në krahasim me Slloveninë ku në vitin 2005 shumica e bizneseve i besonin këtij institucioni (Rus dhe Iglic, 2005).

Ndërkaq, në pyetjen për besueshmërinë në komunën përkatëse, përgjigjet e bizneseve janë pak a shumë të ngjashme me ato për Qeveri,

## BESIMI NË KOMUNË




FIGURA 5. BESIMI NË KOMUNË

## BESIMI NË GJYKATA




FIGURA 6. BESIMI NË GJYKATA

ndonëse distribuimi është pak më pozitiv në këtë rast. Më konkretisht, afërsisht 54% të bizneseve të anketuara nuk besojnë shumë ose fare në komunë, afërsisht 14% janë neutral dhe rreth 33% besojnë deri diku (kjo dominon) ose shumë në këtë të fundit. Arsyeja për këtë ndryshim të lehtë në përgjigjet për Qeveri dhe për komunën përkatëse duhet të jetë fakti se bizneset mendojnë se kompetencat kryesore që ndërlidhen me performancën e tyre kanë të bëjnë me nivelin qendrorë dhe jo lokal.

Prej institucioneve kosovare, bizneset më se paku iu besojnë gjykatave.

Nga të gjitha bizneset e anketuara, del se afërsisht 62% e bizneseve nuk besojnë fare ose jo shumë në gjykata, afërsisht 14% janë neutral dhe 24% besojnë deri diku (kjo dominon) ose shumë në këto institucione.

81% e bizneseve u besojnë shume ose deri diku blerësve, afër 10 janë neutral, ndërsa 9% nuk iu besojnë shumë ose fare.


Bizneset më shumë kanë besueshmëri ndër-personale se institucionale.

## 5.2 REZULTATET PËR BESUESHMËRINË NDËR-PERSONALE

Besueshmëria e bizneseve në furnitorë, blerës dhe staf është e përmblendhur në Figurën 7. Në pyetjen

se sa i besojnë bizneset blerësve del se afër 81% e bizneseve u besojnë shume ose deri diku blerësve, afër 10 janë neutral, ndërsa 9% nuk iu besojnë shumë ose fare. Ngjashëm, në pyetjen që lidhet me besimin e bizneseve në furnitorë del se afër 78% e bizneseve iu besojnë shumë ose deri diku furnitorëve, afër 13% janë neutral, ndërsa afër 9% nuk iu besojnë shumë ose fare këtyre të fundit. Sa i përket besueshmërisë

së brendshme, me saktësi besimit në staf, del se afërsisht 93% përfaqësuesve të bizneseve iu besojnë shumë ose deri diku punëtorëve të brendshëm, afër



**FIGURA 6.** BESIMI NDAJ BLERËSVE, FURNITORËVE DHE STAFIT

3% janë neutral dhe afër 4% nuk iu besojnë shumë ose fare atyre. Përqindja e lartë e kësaj të fundit nuk është e papartishme marrë parasysh faktin se përfaqësuesit (menaxherët apo pronarët) e bizneseve kanë kontakte të shpeshta me punëtorë dhe kontroll në ta.

### 5.3 KRAHASIMI I LLOJEVE TË BESUESHMËRISË

Pra siç shihet nga rezultatet e anketës, bizneset shumë më shumë kanë besueshmëri ndër-perso-

nale se institucionale. Ndonëse këto dyja mendohet ta komplementojnë njëra tjetrën ka bazë teorike edhe për të kundërtën. Sipas paradigmës 'zgjedhja racionale' (rational choice), besueshmëria institucionale dhe ndër-personale e zëvendësojnë njëra tjetrën, që do të thotë se kur bizneset kanë më pak besim në institucione mundohen të krijojnë besueshmëri më të madhe me furnitorë, blerës, apo staf në mënyrë që të vazhdojnë funksionimin e rregullt të kompanisë (Coleman, 1990). Një rast i përafërt është gjetur edhe Bosnjë dhe Hercegovinë, ku besueshmëria ndër-personale e ka dominuar atë institucionale (Rus and Iglic, 2005).

## 6. KONKLUZIONI

Ky studim hedh dritë mbi situatën e përgjithshme të bizneseve që operojnë në Kosovë. Për ta bërë këtë, Instituti Riinvest ka zhvilluar një anketë me një mostër mjaft reprezentative të bizneseve. Nga rezultatet e anketës del se shumica e bizneseve kanë pësuar rënie të shitjeve. Për më shumë, e njëjta sugjeron që një proporcion i madh i shitjeve të këtyre bizneseve bëhet në vend dhe shumë pak eksportohet. Të hyra më së shumti realizohen nga konsumatorët familjarë. Në vazhdim, studimi konstaton se barrierat që lidhen me mungesën e sundimit të ligjit, si psh. konkurrenca jo fer, korrupsioni, funksionimi i gjykatave etj., perceptohen si barrierat me serioze për bizneset kosovare. Ndikimi i tyre madje është rritur ndjeshëm në krahasim me vitin 2011. Në

anën tjetër, barrierat e brendshme, më saktësisht: shkathtësitë e punëtorëve dhe rregullativa e punës, si dhe ato infrastrukturore, më saktësisht: transporti, telekomunikacioni dhe energjia elektrike, janë perceptuar si më pak të dëmshme për bizneset. Megjithatë, në përgjithësi, në krahasim me 2011-ën, del se nga 22 barrierat e krahasueshme (dy janë shtuar në anketën e fundit) në të bërit biznes, 18 kanë pësuar rënie, 3 kanë shënuar përmirësim dhe 1 ka mbetur e pa ndryshuar. Në fund, studimi tregon se përfaqësuesit e bizneseve të intervistuar i besojnë më shumë stafit, furnitorëve dhe blerësve se sa institucioneve, përkatësisht Qeverisë dhe komunës përkatëse.

## 7. REFERENCAT

---

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2012). Statistikat e tregtisë së jashtme 2012. Prishtinë [Raport]

---

Banka Botërore (BB) (2013). 'Corruption Preception Index'. Transperancy International. [Raport]

---

Banka Botërore (BB) (2013). 'Doing Business Report'. [Raport]

---

Banka Botërore (BB) (2012). 'Worldwide Governance Indicators'. [Bazë e të Dhënave]

---

Banka Qendrore e Kosovës (2012). Raporti i Stabilitetit Financiar. Prishtinë [Raport]

---

Coleman, J. S. (1990) Foundations of Social Theory. Cambridge, MA: Harvard University Press.

---

Zyra e BE-së për Krim dhe Inteligjencë (2012). 'Krimi i Organizuar në Kosovë'. [Raport]

---

Instituti Riinvest (2013). 'Të paguash apo të mos paguash'. Prishtinë [Raport që pritet të publikohet]

---

Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP (2013). 'Raportet mbi Ndarjet dhe shpenzimin e Parasë Publike'.

---

Offe, K. (1999) 'HowCan We Trust our Felloë Citizens?', in M. E. Warren (ed.) *Democracy and Trust*, pp. 42–87. Cambridge: Cambridge University Press.

---

OSAC (2013). 'Kosovo 2013 Crime and Safety Report'. Departamenti Amerikan i Shtetit[Rarpot]

---

Rothstein, B. and Stolle, D. (2001) 'Social Capital and Street Level Bureaucracy: An Institutional Theory of Generalised Trust', paper presented at the EURESCO Conference Social Capital: Interdisciplinary Perspectives, Exeter, UK, 15–20 September.

---

Rus, A., & Iglič, H. (2005). Trust, Governance and Performance The Role of Institutional and Interpersonal Trust in SME Development. *International Sociology*, 20(3), 371-391.

---

UNDP (2012). 'Human Development Report'. Private sector and employment. Prishtinë

---

Staber, U. (1998) 'Inter-Firm Cooperation and Competition in Industrial Districts', Special Issue: The Organizational Texture of Inter-Firm Relations *Organization Studies* 19(4): 701–25.

---

Williamson, O. E. (1996) *The Mechanisms of Governance*. New York: Oxford University Press.

---



